

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Burhan Berisha, në çështjen juridike, sipas padisë së paditësit S.S nga fshati..., Komuna Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson N.B avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Ferizaj - Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson S.V, për çështjen kontestuese pagesa e pagave përcjellëse dhe shpërblimit jubilar, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 30.01.2019, merr këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit S.S nga fshati..., Komuna Ferizaj, e ushtruar kundër të paditures Komuna Ferizaj – Drejtoria e Arsimit, si e bazuar.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna Ferizaj - Drejtoria e Arsimit, që paditësit, në emër të tri pagave përcjellëse dhe shpërblimit jubilar, me rastin e pensionimit, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej **1,372.46 €** (njëmijë e treqind e shtatëdhjetë e dy euro e katërdhjetë e gjashtë cent) me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 269.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

## **A r s y e t i m**

Paditësi me datë 25.09.2018, ka parashtruar padi kundër të paditures, lidhur me pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe shpërblimin jubilar në lartësi prej 150%.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë të ushtruar pranë kësaj gjykate, duke deklaruar se tek e paditura ka punuar mbi 40 vite dhe atë nga data 25.02.1974 e deri më datën 25.02.2018 dhe pas kësaj date paditësi është pensionuar për shkak të arritjes së moshës së pensionimit - moshës 65 vjeçare, mirëpo paditësit deri më tani nuk i janë paguar pagat përcjellëse dhe shpërblimi jubilar ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Andaj, kërkoj nga gjykata që ta detyroj të padituren Komuna Ferizaj – Drejtoria e Arsimit, që paditësit në emër të tri pagave përcjellëse pas pensionimit nga 304.99 euro secila dhe shpërblimit jubilar në shkallë prej 150% të një page bazë, t'ia paguaj paditësit, me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga data 25.03.2018 e deri në pagesën definitive, duke përfshirë edhe kompensimin e shpenzimeve të procedurës si vijon: për përpilim të padisë shumën 104 euro, për përfaqësim në një seancë shumën 135 euro dhe për taksën gjyqësore shumë prej 30 euro.

I autorizuari i të paditurës, në përgjigjen e tij në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar mbesim në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke e kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar për faktin se paditësi është pensionuar pasi ka arritur moshën 65 vjeçare, tek e paditura ka punuar mbi 40 vite, ku për çdo 10 vite paguhet shpërblimi jubilar, ndërsa paditësi shpërblimin jubilar e ka arritur para disa vitesh, kur kontrata kolektive nuk ka qenë fuqi dhe me asnjë dispozitë të kësaj kontrate nuk është paraparë fuqia retroaktive e kësaj kontrate. Poashtu, e paditura ka deklaruar se kërkesa për paga jubilarë është e parakohshme sepse paditësi ka shkuar në pension me dt.25.02.2018 e shpërblimi jubilar paguhet me rastin e 7 marsit të çdo viti. Mëtej, i autorizuari i të paditues ka deklaruar se dispozita e nenit 35 pika 8 e Kontratës Kolektive ka përcaktuar se punëtori i cili fiton të drejtën e pensionimit, ka të drejtën e fitimit të pagës bazë, varësisht prej përvojës së punës, e paga bazë e punëtorit teknik në arsimin fillor është 240 euro, andaj, nga kjo bazë, i propozoj gjykatës që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqjese i parashtruan ato në këtë procedurë, bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, ka bërë administrimin e provave si vijojnë: *vendimin e dt.17.04.2018 lëshuar nga Drejtoria e Arsimit në Ferizaj; vërtetimin e përvojës së punës të dt.19.10.2018 lëshuar nga SHFM "Jeronim De Rada" pasqyrën e llogarisë bankare të paditësit për periudhën 01.01.2018 – 17.10.2018; listën e pagave të punëdhënësit me nr.10-93941-656-0912.*

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, ka gjetur se duhej vendosur si në dispozitiv.

Gjykata pas administrimit dhe analizimit të provave ka vërtetuar këtë gjendjen faktike: nuk është kontestuese në mesë palëve ndërgjyqjese, se paditësi e ka përvojën e punës mbi 40 vjet si punëtor teknik tek e paditura dhe se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension. Po ashtu, nga deklarimi i palëve ndërgjyqjese gjykata ka konstatuar se nuk është kontestuese se paditësi në tre muajt e fundit para pensionimit ka realizuar pagë mesatare prej 304.99 euro apo për tre muaj së bashku në shumë të përgjithshme prej 914.97 euro, andaj gjykata gjen të panevojshme të elaborojë mëtej bazën juridike sa i përket këtyre dy pikave të lartpërmenduar.

Pretendimi i të paditues se shpërblimi jubilar caktohet në bazë të pagës bazë të punëtorit, e jo sipas pagës së realizuar, sepse paga bazë e punëtorit teknik në arsimin fillor është 240 euro, ndërsa paditësi ka realizuar pagë mesatare në shumë prej 304.99 euro për shkak të shtesave nga përvoja e punës, për gjykatën edhe ky pretendim është i pabazuar, sepse e paditura me asnjë fakt dhe me asnjë provë nuk e ka mbështetur pretendimin e saj në këtë pikë kontestuese, andaj gjykata me rastin e vendosjes të lartësisë së kërkesëpadisë, është bazuar në provat materiale të cilat i ka ofruar paditësi, siç janë: *pasqyra e llogarisë bankare në emër të paditësit dhe lista e pagave e lëshuar nga e paditura.*

Pretendimi i të paditues se shpërblimi jubilar paguhet për çdo 10 vite, ndërsa paditësi shpërblimin jubilar e ka arritur para disa vitesh, kur kontrata kolektive nuk ka qenë fuqi, për gjykatën ky pretendim është i pabazuar, sepse shpërblimi jubilar llogaritet shkallë shkallë (në përqindje) varësisht sa dekada (jubile) pune i ka kaluar punëmarrësi deri në datën e pensionimit dhe shpërblimi jubilar arrinë për pagesë vetëm pasi që paditësi – punëmarrësi të ketë arritur moshën e pensionimit, e që në rastin konkret, në momentin e pensionimit të paditësit, Kontrata Kolektive ka qenë në zbatim. Poashtu, pretendimi i të paditues se kërkesa për shpërblim jubilar është e parakohshme, ngase paditësi ka shkuar në pension me dt.25.02.2018 e shpërblimi jubilar paguhet me rastin e 7 marsit të çdo viti, për gjykatën edhe ky pretendim është i pabazuar, sepse paditësi ka shkuar në pension saktësisht dhjetë ditë para datës 7 mars. Kërkesa për realizimin e të drejtave në paga përcjellëse dhe shpërblim jubilar, që dalin nga dispozitat e Kontratës Kolektive, duhet të paguhet nga punëdhënësi i fundit, brenda afatit prej 30 ditë nga data e pensionimit, çka do të thotë se e paditura, ka qenë e obliguar paditësit t’ia bëjë pagesën e pagave përcjellëse dhe shpërblimit jubilar, pa pasur nevojë t’i drejtohet paditëses me kërkesë direkte apo përmes gjykatës.

Nga arsyet e lartëcekura, konform nenit 143 dhe 319 të LPK-së, lidhur me nenin 35 par. 8.4 të Kontratës Kolektive për Arsim Parauniversitar e datës 18.04.2017 si dhe nenit 382 par.2 i LMD-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata ka vendosur konform nenin 452.1 të LPK-së, me çka e ka detyruar të paditues që paditësit t’ia paguan shpenzimet e procedurës në shumë prej 269.00 € dhe atë si në vijim: për përpilim të padisë shumë 104.00 €, për përfaqësim në një seancë shumë 135.00 € dhe për taksën gjyqësore shumë 30.00 €.

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**  
**C.nr.910/18 datë 30.01.2019**

*Gjyqtari,*  
**Burhan Berisha**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.